




01-791

	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	---	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-103526/22 dt. 12.05.2022, të pronarëve Bardhyl Sopi, Tafil e Nazmi Thaqi nga Prishtina dhe investitorit investitor “Sima Com” Sh.p.k. dega në Kosovë, me përfaqësues Edmond Luli nga Puka, R. E Shqipërisë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, “Ndërtesa 2” me etazhitet 2B+P+7ET ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 10.01.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Bardhyl Sopi, Tafil dhe Nazmi Thaqi nga Prishtina, me investitorin “Sima Com” Sh.p.k. dega në Kosove, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810805351, me përfaqësues Edmond Luli nga Puka, R. E Shqipërisë, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-103526/22 dt. 12.05.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht “Ndërtesa 2” me etazhitet 2B+P+7ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 035-280133 dt. 09.06.2015, në kuadër të bllokut urban “A10” të tërësisë urbane “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1527-0, ZK Matiçan, me qasje në rrugën “Ndue Perllëshi”.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Ndue Perllëshi” ku është dalja/hyrja e kësaj ndërtese me numër: 165 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Ar sy e t i m

Pronarët Bardhyl Sopi, Tafil dhe Nazmi Thaqi nga Prishtina dhe investitori "Sima Com" Sh.p.k. dega në Kosovë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810805351, me përfaqësues Edmond Luli nga Puka, R. E Shqipërisë, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-103526/22 dt. 12.05.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, përkatësisht "Ndërtesa 2" me etazhitet B+P+7ET, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "A10" të tërësisë urbane "A" të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1527-0, ZK Matičan, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 035-280133 dt. 09.06.2015, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-23031/21 dt. 14.11.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Donjeta Alloqi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Islam Nitaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetllësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Avdi Çitaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Valon Hajrizaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Naim Hoti; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Kadri Haliti, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga Gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa me nr. të licencës 09;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetllësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat

nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuar-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesa shumë banesore me afarizëm.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI


Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-103526/22 DT. 10.01.2023**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Drejtori,
Arber Sadiki

